



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti - Republika Kosova – Republic of Kosovo

**MAMUŞA BELEDİYESİ - KOMUNA E MAMUSHËS
OPSTINA MAMUSA - MUNICIPALTY OF MAMUSA**

KUVENDI I KOMUNËS SË MAMUSHËS

RREGULLORE

MBI

**KOMPENSIMET NË PROCEDURËN E KRYERJËS SË MBIKËQYRJËS
INSPEKTUESE PËR PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE HIGJENIKE-TEKNIKE**

Në baze të nenit 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 si dhe të Statutit të Komunës së Mamushës , Kuvendi i Komunës së Mamushës në mbledhjen e mbajtur më datë 25.09.2009 miratoi këtë :

RREGULLORE
MBI
KOMPENSIMET NË PROCEDURËN E KRYERJËS SË MBIKËQYRJES
INSPEKTUESE PËR PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE HIGJENIKE-TEKNIKE

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet lartësia e shpenzimeve të bëra në procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese (Komisioni Komunal), sipas kërkesës së palës me qëllim të përcaktimit të plotësimit të kushteve minimale, në shqyrtimin e hapësirave punuese, pajisjeve dhe stabilimenteve, kushteve higjienike-sanitare dhe kushteve të mbrojtjes në punë, për fillimin e punës dhe kryerjes së veprimtarisë.

Neni 2

Parashtruesi i kërkesës është i obliguar që para parashtrimit të kërkesës në emër të kompensimeve të procedurës së mbikëqyrjes inspektuese të paguaj shumën e caktuar në të holla sipas objektit dhe atë:

Nr. r.	E m ë r t i m i	Vlera në €uro
1	Objektet industriale - prodhuese	200
2	Shitoret me shumicë - depot	100
3	Shitja e derivateve të naftës	80
4	Hotelet dhe motelet me restorante	100
5	Restorantet	80
6	Klinikat dhe ordinancat mjekësore	80
7	Barnatoret Humane	100
8	Laboratorët Biokimik	100
9	Barnatoret Bujqësore	100
10	Vetëshërbimet	70
11	Gjellëtoret, ëmbëltoreset, kafiteritë	50
12	Dyqanet e pavarur tregtare	30
13	Dyqanet e pavarura zejtare	20
14	Serviset e TV, Radio aparateve, pajisjeve të amvisërisë etj.	20
15	Zyrat për përkthim në gjuhët e huaja	30
16	Avukaturat	100
17	Kioskat	10
18	Agjensit turistike dhe të sigurimit	50
19	Zyrat administrative - selia e biznesit	30
20	Auto parkingjet	20
21	Pishinat	30
22	Hekurishtat	100
23	Auto larje	30
24	Vullkanizer (Gomister)	30

25	Bankat	200
26	PTK	200
27	Këmbimoret	50
28	Fushat sportive	50
29	Objektet për përpunimin e qumështit	50
30	Feramat	50
31	Prodhuesit individual të pijeve	80
32	Qendrat Tregtare	200
33	Supermarketet, Hipermarketat	200
34	Automekanikët	30
35	Auto elektrikistit	30
36	Seperacionet	80
37	Prodhimi i gypave, kubëzave etj. prej betoni	150
38	Prodhimi i gypave, dyerve, dritareve etj. prej plastike	150
39	Depot e materialit ndertimor	200
40	Zdrukëthtarët - Marangozët	80
41	Të tjera	80

Neni 3

3.1 Për vlerësimin mbi plotësimin e kushteve minimale teknike-sanitare, për ushtrimin e veprimtarisë së hapsirave lokaleve, stabilimenteve dhe pajisjeve duhet të formohet komisioni përkatës i përbërë nga këta inspektor: Inspektori i Punës, tregut, sanitar ndërsa inspektorët tjerë sipas nevojës.

3.2 Ky komision mbikëqyrjen e kryen në orar të punës respektivisht ditëve të punës.

Neni 4

4.1 Shumën në të holla të përcaktuar në emër të kompensimit të shpenzimeve të parapara sipas neni 2 të kësaj Rregulloreje, parashtruesi i kërkesës duhet të kryej pagesën në bankat, në llogarinë e Kuvendit Komunal të Mamushës - "Kontrolli sipas kërkesës së palës".

4.2 Parashtruesi me rastin e parashtrimit të kërkesës së tij për dhënien e pëlqimit paraprakisht duhet të kryej pagesën sipas alinesë paraprake të këtij neni.

Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi me datën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MAMUSHËS

01 Nr. 005-09 Data 25 Shtator 2009

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Seylan Mazrek